

Vendim nr. 323, datë 04.12.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Asim Vokshi, Anëtar

Genti Ibrahimimi, Anëtar

në datën 04.12.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (R) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ROLAND MATRANXHI**, përfaqësuar nga avokat Anton Kosteri, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 151 (360), datë 18.01.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 188, datë 09.05.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2024-2161(167), datë 04.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim gjyqësor në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 31, 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 71, pika 1 dhe 71/a, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 11.11.2017 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka regjistruar procedimin penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 76 e 279 të Kodit Penal (KP) dhe në datën 08.02.2018 ka paraqitur kërkesë për dërgimin e kësaj çështjeje në gjyq, duke akuzuar kërkuesin, i mitur në konflikt me ligjin, për kryerjen e veprës penale “Vrasja me dashje”, të parashikuar nga neni 76 i KP-së. Në datën 06.03.2018, për shkak se ka rezultuar se edhe viktima ishte i mitur, prokuroria ka ndryshuar akuzën për kërkuesin në atë për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “a”, i KP-së.

2. Në seancën paraprake të datës 13.03.2018, kërkuesi dhe mbrojtësi i tij kanë kërkuar gjykimin sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar. Me vendim të po asaj date, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes së kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “a”, i KP-së.

3. Në seancë gjyqësore, përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, mbrojtësi i zgjedhur i kërkuesit ka deklaruar se i qëndron kërkesës për gjykim të shkurtuar të paraqitur në seancën paraprake. Ajo gjykatë, bazuar në parashikimet e nenit 403, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, ka rrëzuar kërkesën për gjykim të shkurtuar, duke vlerësuar se kërkuesi akuzohet sipas nenit 79, shkronja “a”, të KP-së, që parashikon dënim me burgim të përjetshëm, çka përbën kriter ndalues për pranimin e gjykimit të shkurtuar. Për rrjedhojë, gjykimi i kërkuesit ka vijuar me ritin e gjykimit të zakonshëm.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 151 (360), datë 28.01.2019, ka vendosur deklarimin faktor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “a”, i KP-së dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim. Kundër vendimit ka paraqitur ankim kërkuesi.

5. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 188, datë 09.05.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kundër vendimit ka paraqitur rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në datën 25.04.2024, në dhomën e këshillimit, ka vlerësuar se në rekurs janë ngritur çështje ligjore me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, në vështrim të kërkesave të nenit 432, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, ndaj ka çmuar të njësojë praktikën gjyqësore, për shkak se ka konstatuar praktika të ndryshme të atij

kolegji në drejtim të zbatimit të nenit 403, pika 2, të KPP-së, për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm kur të akuzuar janë persona ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi të tillë. Në zbatim të nenit 438 të KPP-së, Kolegji Penal, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, me qëllim njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në lidhje me: A zbatohet neni 403, pika 2, i KPP-së për personat e akuzuar për një krim që KP-ja parashikon dënim me burgim të përjetshëm, por ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi të tillë?; A zbatohet procedura e gjykimit të shkurtuar kur akuza është për një vepër penale që përmban dënimin me burgim të përjetshëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë?; Si do të veprohet në rastin kur akuza është ngritur për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe gjyqtari i seancës paraprahe e dërgon në gjyq për këtë akuzë, por gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonshëm i japin faktit një cilësim tjetër juridik, që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm?

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka dëgjuar edhe qëndrimin e Prokurorisë së Përgjithshme, me vendimin nr. 00-2024-2161 (167), datë 04.07.2024, në lidhje me pyetjen e parë ka mbajtur qëndrimin njësuës: *“Ndalimi i parashikuar nga neni 403, pika 2, i KPP-së zbatohet edhe për subjektet ndaj të cilave ligji penal ndalon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm.”*. Në lidhje me nënçështjen e parë të shtruar për njësim, në përfundim të analizës së tij, Kolegji Penal ka mbajtur qëndrimin njësuës: *“Kur akuza është për një vepër penale që përmban dënimin me burgim të përjetshëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë, nuk zbatohet procedura e gjykimit të shkurtuar.”*, kurse në lidhje me nënçështjen e dytë të shtruar për njësim, ka mbajtur qëndrimin: *“Nëse gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonshëm i japin faktit një cilësim tjetër juridik për një vepër penale që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm, duhet të zbatojnë nenin 406, pika 1, të KPP-së në lidhje me masën e dënimit edhe nëse akuza është ngritur për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe gjyqtari i seancës paraprahe e ka dërguar në gjyq për këtë akuzë. Ky përfundim zbatohet me kusht që të plotësohen elementet e mëposhtme: a. Të jetë paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar nga i pandehuri në përputhje me parashikimet e paragrafit të parë të nenit 403 të KPP-së, e shoqëruar me kërkimin e tij për ndryshimin e cilësimit juridik të faktit, për një vepër penale që nuk parashikon dënim me burgim të përjetshëm; b. Të çmohet që çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, duke mbajtur në konsideratë edhe pikën 7 të nenit 405 të KPP-së.”*.

8. Në lidhje me çështjen e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke vlerësuar se, referuar akteve të dosjes gjyqësore, vendimmarrjes së gjykatave dhe shkaqeve të ngritura në rekurs, vendimi i kundërshtuar

duhet të lihet në fuqi. Sipas atij kolegji, pretendimet për pavlefshmërinë e akteve dhe papërdorshmërinë e provave janë të pabazuara dhe kanë marrë përgjigje të argumentuar nga gjykata e apelit, kurse pretendimet për cilësimin e gabuar të faktit penal lidhur me vrasjen e viktimës së mitur lidhen me pretendime të karakterit faktual, ndaj dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Kolegji Penal ka vlerësuar se cilësimi juridik i veprës penale sipas nenit 79, shkronja “a”, të KP-së është në interpretim të drejtë të ligjit material penal dhe se pretendimi i mbrojtjes për ndryshimin e cilësimit të faktit penal në veprën penale të parashikuar nga neni 83 i KP-së është i pabazuar dhe se ai ka marrë përgjigje të argumentuara nga të dyja gjykatat. Po sipas atij kolegji, vendimmarrja e gjykatave është e arsyetuar, duke u dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve që janë ngritur në rekurs, ashtu edhe në respektim të standardit provues “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”. Në përfundim, Kolegji Penal ka vlerësuar se neni 79, shkronja “a”, i KP-së, për të cilin është akuzuar dhe dënuar kërkuesi, i mitur në konflikt me ligjin, parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe neni 403, pika 2, i KPP-së ndalon gjykimin e shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm, duke e gjetur të drejtë përfundimin e gjykatave të faktit për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar.

9. Në datën 28.07.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të Ligjit Organik të saj, është regjistruar në datën 20.08.2025.

10. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për një gjykim të drejtë në drejtim:

11.1. *Mospranimin të kërkesës për gjykim të shkurtuar*, çka ka sjellë që vendimet e gjykatave të faktit të jenë në kundërshtim me ligjin dhe parimet themelore të së drejtës penale, pasi i kanë mohuar një të drejtë që i takon të pandehurit me ligj.

Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë që ka lënë në fuqi këto vendime, bazuar në interpretimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së, është në shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së. Duke e konsideruar të drejtën për të kërkuar aplikimin e gjykimit të shkurtuar si një avantazh në favor të të pandehurit, gjykatat nuk mund të mos pranojnë kërkesën për aplikimin e këtij lloj gjykimi dhe që më pas të aplikojnë uljet e parashikuara ligjore.

11.2. *Cenimit të parimeve të caktimit të dënimit penal* që janë ato të ligjshmërisë, proporcionalitetit, barazisë, drejtësisë dhe humanizimit. Nenet 31 dhe 51 të KP-së dhe dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (*KDPM*) janë norma të veçanta përjashtimore, që ndalojnë aplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm për një kategori të veçantë personash, përfshirë të miturit në konflikt me ligjin. Neni 403 i KPP-së synon ndalimin e përfitimit nga gjykimi i shkurtuar vetëm ndaj personave që janë subjekte të dënimit penal “burgim i përjetshëm”. Kjo do të thotë se për sa kohë që i mituri në konflikt me ligjin nuk është subjekt i këtij dënimi (me burgim të përjetshëm), i cili nuk lidhet vetëm me anën objektive të veprës penale, por mbi të gjitha me subjektin dhe anën subjektive, ndalimi për përfitimin nga gjykimi i shkurtuar nuk mund të zbatohet ndaj kësaj kategorie.

11.3. *Parimit të interesit më të lartë të të miturit*, i cili është cenuar nga qëndrimi i Gjykatës së Lartë. Në kuptim të parimit të proporcionalit të ndërhyrjes, sipas nenit 17 të Kushtetutës, duke qenë se ndodhemi në kushtet kur ligjvënësi nuk e ka saktësuar nëse duhet të aplikohet ose jo gjykimi i shkurtuar për të miturit kur ata akuzohen për një veprë që parashikon burgim të përjetshëm, Gjykata e Lartë ka vepruar drejt që e ka shtruar për njësim këtë vakuim të KPP-së, mirëpo përfundimi i asaj gjykate është tërësisht i gabuar. Kjo sepse në rastin konkret Gjykata e Lartë duhej të interpretonte në mënyrë të zgjeruar ligjin në harmoni me aktet themelore, sidomos me Kushtetutën, KEDNJ-në dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Interpretimi i dispozitës në mënyrë sipërfaqësore dhe të ngushtë është një shkelje e parimeve të caktimit të dënimit penal dhe qëllimit të dënimit në vetvete. Gjykata e Lartë ka anashkaluar haptazi rregullin esencial që duhet të aplikohet në çdo rast kur trajtohen/diskutohen të drejtat e të miturve dhe që është interesi më i lartë i të miturit. Është i vërtetë fakti se të miturit përfitojnë nga KDPM-ja, duke iu zbritur gjysma e dënimit, por Gjykata e Lartë ka analizuar

se këto përfitime janë të mjaftueshme, prandaj nuk është i nevojshëm aplikimi i gjyqimit të shkurtuar për të aplikuar edhe një zbritje tjetër në dënimin për të miturit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar formalisht mjetet juridike të zakonshme në dispozicion ndërkohë që për kundërshtimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ai nuk ka mjet tjetër ankimi përveç ankimit kushtetues individual.

15. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, vendimi më i fundit gjyqësor i dhënë në çështjen e kërkuësit, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 04.07.2024 dhe rezultoi të jetë komunikuar përfaqësuesit të kërkuësit nga administrata e Gjykatës së Lartë në datën 26.03.2025, përmes postës elektronike, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 28.07.2025. Në situatën që afati 4-mujor ka mbaruar më 26.07.2025, që është ditë pushimi javor (ditë e shtunë), ai është shtyrë ditën pasardhëse të punës, sipas parashikimeve të nenit 15, pika 3, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës. Për rrjedhojë, konsiderohet se kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor ndaj kërkuësi legjitimohet *ratione temporis*.

16. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka ngritur pretendime për mënyrën sesi Gjykata e Lartë ka interpretuar nenin 403 të KPP-së që parashikon ndalimin për të përfituar nga e drejta për gjykim të shkurtuar edhe nga të miturit në konflikt me ligjin, në rastin kur akuzohen për një vepër penale për të cilën aplikohet dënimi me burgim të përjetshëm. Sipas kërkuesit, ky qëndrim bie ndesh me të drejtën për gjykim të drejtë, në drejtim të së drejtës së të pandehurit për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar, si dhe me parimet e qëllimet e dënimit penal dhe me interesin më të lartë të miturit. Për rrjedhojë, referuar natyrës dhe thelbit të pretendimeve të kërkuesit, Kolegji vlerëson se ato kanë të bëjnë me të drejtën për të mos u dënuar pa ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

17. Gjykata, për sa i përket natyrës dhe kufijve të gjykimit kushtetues, ka theksuar se ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 34, datë 17.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Po kështu, Gjykata ka pohuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme dhe ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë e ligjit, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit (*shih vendimet nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në vlerësimin e Gjykatës autonomia e interpretimit të saj nuk është e pakufizuar, por ndalet përpara interpretimit të qëndrueshëm jurisprudencial të gjykatave të zakonshme, pasi edhe në autonominë e saj të plotë të gjykimit kjo Gjykatë nuk mund të mos ketë parasysh një interpretim të tillë që i njeh normës legjislative vlerën e saj efektive në jetën juridike, duke qenë se normat janë jo ato që propozohen në mënyrë abstrakte, por ato që zbatohen nëpërmjet interpretimit të gjyqtarit, çka i bën ato norma konkrete dhe të prekshme për palët (*shih vendimin nr. 6, datë, 17.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Kolegji, bazuar në aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, vëren se gjykata e shkallës së parë nuk e ka pranuar kërkesën e kërkuesit për gjykim të shkurtuar, duke vlerësuar se neni 403, pika 2, i KPP-së nuk lejon aplikimin e këtij gjykimi në rastet kur vepra penale parashikon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm, siç është rasti i kërkuesit, i cili është gjykuar dhe dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 79, shkronja “a”, i KP-së, dispozitë që parashikon mundësinë e dhënies së dënimit me burgim të përjetshëm. Ky qëndrim është vlerësuar i drejtë edhe nga gjykata e apelit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i vënë në lëvizje me rekursin e kërkuesit, duke vlerësuar se në të janë ngritur çështje ligjore me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe në situatën që ka konstatuar praktika të ndryshme të atij kolegji në drejtim të zbatimit të nenit 403, pika 2, të KPP-së, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me qëllim njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Ai kolegji ka përcaktuar edhe çështjet për njësim, ku çështja kryesore lidhet me zbatimin e nenit 403, pika 2, të KPP-së për personat e akuzuar për një krim për të cilin KP-ja parashikon dënim me burgim të përjetshëm, por ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi të tillë, ku përfshihen edhe të miturit në konflikt me ligjin. Në përfundim të gjykimit, në lidhje me çështjen kryesore të shtruar për njësim, Kolegji Penal, në analizë të përmbajtjes së nenit 403 të KPP-së, të dispozitave penale materiale dhe procedurale dhe atyre të KPDM-së, në interpretim të instituteve të së drejtës penale, si dhe duke iu referuar praktikës së Gjykatës dhe të GJEDNJ-së për sa i përket së drejtës për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar, sikundër asaj të Gjykatës Kushtetuese të Italisë, në kushtet që dispozita procedurale penale është huazuar nga KPP-ja italiane, ka arritur në përfundimin se ndalimi i parashikuar nga neni 403, pika 2, i KPP-së zbatohet edhe për subjektet ndaj të cilave ligji penal ndalon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm. Sipas Kolegjit Penal, trajtimi sanksionues i privilegjuar, i toleruar nga ligjvënësi edhe për të miturit në konflikt me ligjin, që presupozon pamundësinë e aplikimit ndaj tyre të dënimit me “burgim të përjetshëm” ashtu edhe të një dënimi më të lartë se 12 vjet burgim, nuk paraqet asnjë lloj ndikimi në drejtim të evitimit të ndalimit të përgjithshëm të përcaktuar në nenin 403, pika 2, të KPP-së, përjashtues *apriori* i së drejtës për të

pasur akses në ritin procedural të gjykimit të shkurtuar të subjekteve të gjykuara për vepra penale që parashikojnë si titull sanksionues llojin e dënimit me burgim të përjetshëm (*shih paragrafët 55 e 56 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

21. Në një çështje të ngjashme të shqyrtuar nga Gjykata përpara dhënies së vendimit të mësipërm njësues nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ajo ka vërejtur se, në analizë të KDPM-së, nuk rezulton asnjë normë e posaçme që të përcaktojë në mënyrë të shprehur zbatimin e gjykimit të shkurtuar për të miturit në konflikt me ligjin, të cilët dënohen për vepra penale për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm, për rrjedhojë janë gjykatat që, përmes interpretimit që u bëjnë dispozitave ligjore, qartësojnë normat dhe unifikojnë zbatimin e tyre në vendimet gjyqësore, duke i bërë ato të aksesueshme për publikun (*shih vendimin nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj si gjykatë e ligjit, ka interpretuar përfundimisht dispozitat procedurale penale që ndalojnë aplikimin e ritit të gjykimit të shkurtuar për veprat penale që parashikojnë dënimin me burgim të përjetshëm, duke arritur në përfundimin se ato zbatohen në të njëjtën mënyrë edhe për të miturit në konflikt me ligjin, pra edhe në rastin e kërkuesit.

22. Kolegji vlerëson se interpretimi i bërë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në rastin e kërkuesit, i cili përfundimisht ka lënë në fuqi vendimet e gjykatave të faktit të dhëna ndaj tij, nuk rezulton që të mos respektojë kërkesat kushtetuese për një gjykim të drejtë ose të bjerë ndesh me vetë thelbin e kësaj të drejte. Ky vendim nuk rezulton të jetë i pamjaftueshëm, të ketë kundërtënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë, të jetë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm apo të mos respektojë parimet dhe standardet kushtetuese të elaboruara në jurisprudencën e kësaj Gjykate. Në këto kushte, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit për mënyrën e interpretimit dhe zbatimin në çështjen e tij të dispozitave ligjore penale që rregullojnë institutin e gjykimit të shkurtuar, në drejtim të së drejtës për të mos u dënuar pa ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, janë haptazi të pabazuara.

23. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.